



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 10 korrik 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3292_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084); Nenin 19 paragrafin 2 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, Vendimi për Lëshimin e Autorizimit V_2557_2024 të datës 12 nëntor 2026 për shoqërinë "Solar GATE" L.L.C., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Llapashticë e Epërme, komuna e Podujevës dhe kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizim V_2557_2024 edhe për 12 (dymbëdhjetë) muaj, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Llapashticë e Epërme, komuna e Podujevës, të datës 04.05.2026 nr. prot. 413/26 të shoqërisë "Solar GATE" SH.P.K., me adresë: Rr. "Arkitekt Karl Gega 34", Prishtinë, Republika e Kosovës; dhe

në seancën e mbajtur më 10 korrik 2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "Solar GATE" L.L.C., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së autorizimit V_2557_2024 të datës 12 nëntor 2024 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Llapashticë e Epërme, komuna e Pejës.
- II. OBLIGOHET** - shoqëria "Solar GATE" L.L.C., që brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të këtij Vendimi për vazhdim të afatit të vlefshmërisë së Vendimit V_2557_2024, që të dorëzojë garancionin financiar në vlerë prej 7% të vlerës së projektit, të lëshuar nga një Bankë Komerciale e licencuar apo kompani e sigurimeve në Republikën e Kosovës, me vlefshmëri që mbulon periudhën sipas Planin Dinamik të Realizimit të Aplikuesit.
- III.** Garancioni financiar sipas pikës II. të këtij Vendimi, do të jetë në vlerën prej 136,500.00€ (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind Euro), sipas vlerës së projektit të prezantuar me Planin e Biznesit me rastin e aplikimit për Autorizim dhe duhet të mbulon periudhën deri **30.06.2027**.
- IV.** Kushtet tjera të vendosura me Vendimin V_2557_2024 mbesin të pa ndryshuara dhe duhet të zbatohen nga aplikuesi.



Arsyetim

- ZRRE, me datë 04.05.2026, nga "Solar GATE" L.L.C., ka pranuar kërkesën për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit V_2557_2024, të datës 12 nëntor 2024, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW.
- Në kërkesën e saj, aplikuesi ka arsyetuar se gjatë realizimit të projektit është përballur me pengesa administrative lidhur me shtrirjen e kabllit në zonën urbane, të cilat kanë kërkuar ndryshimin e zgjidhjes teknike dhe përcaktimin e një traseje alternative në koordinim me Komunën e Podujevës dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes. Sipas aplikuesit, këto rrethana kanë qenë jashtë kontrollit të tij dhe kanë shkaktuar vonesa në realizimin e projektit.
- Aplikuesi, në mbështetje të kërkesës, ka dorëzuar dokumentacionin përkatës, përfshirë kontratën EPC për ndërtimin e projektit, Pëlqimin Elektroenergetik të reviduar të KEDS-it, fotografi nga vendpunishtja që dëshmojnë progresin e punimeve, si dhe dokumente të tjera mbështetëse.
- ZRRE ka analizuar kërkesën për shtyrje të afati të vlefshmërisë së autorizimit ku nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se aplikuesi ka ndërmarrë veprime konkrete për realizimin e projektit, përfshirë sigurimin dhe përditësimin e dokumentacionit teknik, vazhdimin e procedurave për realizimin e kyçjes në rrjet, lidhjen e kontratës për realizimin e projektit, si dhe ka paraqitur dëshmi që tregojnë progres në realizimin e punimeve. Këto dokumente janë marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të kërkesës nga Bordi.
- Kërkesës për shtyrje e kanë bazuar në Rregullën nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve energjetike, respektivisht Nenin 19.1, që parasheh që autorizimi i lëshuar nga ZRRE është i vlefshëm për periudhën 24 muajsh, dhe sipas Nenit 19 par. 2 Aplikuesi mund të kërkojë që të vazhdojë afatin e përcaktuar me par. 1, edhe për 12 muaj të tjerë, me arsye se një zgjatje e tillë ka qenë jashtë kontrollit të aplikuesit. Prandaj kanë kërkuar se afati të shtyhet për një periudhë shtesë, për finalizimin e projektit.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës për shtyrje të afatit të Autorizimit, dëshmime të bashkangjitura, ka ardhur në përfundim se në aspektin administrativ dhe arsyeve faktike të prezantuara nga dëshmitë përkatëse duke pasur parasysh edhe vonesat kanë ardhur si rezultat i pengesave administrative lidhur me shtrirjen e kabllit në zonën urbane, të cilat kanë kërkuar ndryshimin e zgjidhjes teknike dhe përcaktimin e një traseje alternative në koordinim me Komunën e Podujevës dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, të cilat vonesa vlerësohen se janë jashtë kontrollit të aplikuesit, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Podujevës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.